



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.62/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Fejzullah Rexhepi kryesues, Rustem Thaqi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur lidhur me apelin e Xhemile Cakiqi e lindur në Podujevë, të paraqitur kundër vendimit të Komisioni Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 06 tetor 2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 20.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet si i palejuar apeli Anr.62/2019, i datës 20.09.2019, i parashtruar nga Xhemile Cakiqi e lindur në Podujevë me të cilin ka kërkuar që të përfshihet në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës.

A r s y e t i m

Me datë 20.09.2019, PZAP-i ka pranuar një apel nga Xhemile Cakiqi, në të cilën parashtruesja e apelit pretendon se i është mohuar e drejta për të votuar pasi që nuk është përfshirë në listën e përgjithshme të votuesve, edhe pse sipas saj e njëjta ka lindur në Kosovë dhe ka të drejtën e dyshtetësisë.

Parashtruesja e apelit si dëshmi për pretendimet e saj ka bashkangjitur një ekstrakt nga libri amzë i të lindurve të lëshuar nga UNMIK-u më datë 24.09.2001.

Në përgjigjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) të datës 20.09.2019, theksohet se përgjatë periudhës së aplikimit për regjistrim, apellesja Xhemile Cakiqi ka aplikuar për votim jashtë Kosovës dhe se të njëjtës i është refuzuar kërkesa pasi që e njëjta nuk e ka dëshmuar identitetin e saj me ndonjë dokument valid të identifikimit duke mos plotësuar kështu kushtet ligjore për tu përfshirë në listën votuese jashtë Kosovës.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimet e apelit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i palejuar

Paneli, pasi që shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i palejuar pasi që parashtruesja e apelit gjatë aplikimit të saj për regjistrim për votim jashtë Kosovës, nuk i ka plotësuar kriteret ligjore për tu futur në listë.

Në nenin 115.1 të LZP është përcaktuar se PZAP është organ i përhershëm, i pavarur kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet e lejuara që kanë të bëjnë lidhur me procesin zgjedhor siç është caktuar me këtë ligj dhe rregullat zgjedhore, ndërsa neni 11.5 i rregullës zgjedhore Nr. 02/2015 Rregullat dhe procedurat, përcakton se: “PZAP-i i hudhë poshtë me vendim apelet të cilat janë të palejuara dhe të pasafatshme”. Nga shkresat e lëndës Paneli gjeti se dosja e parashtrueses së apelit në momentin e aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës nuk ka qenë e kompletuar pasi që apeluësja nuk ka arritur që të dëshmojë identitetin e saj me ndonjë dokument valid të identifikimit.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, 122 par.1 pika a) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.5 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 62/2019 më datë 20.09.2019



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.